



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA**

C.nr.1386/18

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË-Departamenti i përgjithshëm civil,** sipas gjyqtarit, Ganimete Puka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit : Hazir Demaku, Bahtir Demaku, Imer Demaku, Isak Demaku që të gjithë nga fshati Zahaq, Komuna Pejë, të cilin e përf. av. Mustaf Maloku nga Peja, kundë të paditurit : Stankoviq Hlinka e veja e Milloshit nga fshati Zahaq, Komuna Pejë, tani me vendbanim të panjohur, baza juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1.000 euro, jashtë seancës me datë: 28.06.2021 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Të paditurës Stankoviq Hlinka e veja e Milloshit nga fshati Zahaq, Komuna Pejë, tani me vendbanim të panjohur, ia cakton përfaqësuesin e përkohshëm av. Blerim Ademaj nga Peja.

Përfaqësuesi i përkohshëm është i obliguar që të mbrojë dhe përfaqësoi interesat e të paditurit deri sa njëjti të paraqitet personalisht në gjykatë apo përfaqësuesi me prokurë i tij gjegjësisht deri sa Qendra për Punë Sociale në Pejë, ta njoftoi gjykatën se të njëjti i është caktuar një kujdestar.

Ky aktvendim do të publikohet në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës, Gazetën Koha Ditore, do afishohet në tabelën e shpalljes së gjykatës dhe do të njoftohet QPS në Pejë.

Shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm i bartë paditësi

**A r s y e t i m**

Paditësit në këtë gjykatë me datë: 17.12.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurit, për vërtet pronësie, vlera e kontestit 1.000€,

Gjykata për të krijuar kushte procedurale sipas detyrës zyrtare në këtë çështje juridike, të paditurit, të me adresë të panjohur, ia caktohen përfaqësuesin e përkohshëm av. Blerim Ademaj nga Peja, në kupt të dispozitave të nenit 79 par.3 pika a) dhe b) , nenit 81 .82 dhe 83 të LPK/së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,**  
**C.nr.1386/18 të dt. 28.06.2021**

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta e ankesës.

